



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.281/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesë e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.281/2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesën Anr.281/2025, nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK , me seli në Pejë kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane-PLE me seli në Pejë, me të cilën pretendohet se Bashkim Krasniqi, nënkryetar i partisë, Liberale Egjiptiane (PLE), më datën 31.01.2025, në ora 08:50 AM, ka publikuar në profilin e tij në facebook një video me mbishkrimin “ Punët e mira i bëjmë vet ne”, të cilës i ka bashkangjitur një video nga Tiktok, ku shihen fëmijët e moshës nën 15 vjeçare. Më tutje theksohet se në këtë mënyrë Bashkim Krasniqi në cilësi të nënkryetarit të PLE-së, në këtë fotografi ka keqpërdorur fëmijët e mitur për qëllime politike dhe gjatë fushatës zgjedhore, sidomos ata të moshës nën 15 vjeçare, duke e ditur se fëmijët janë kategori e ndjeshme e shoqërisë dhe ekspozimi i tyre për qëllime politike është i

kundërligjshëm dhe bie ndesh me nenin 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 Fushata e Zgjedhjeve, Monitorimi i Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimi Financiar.

Parashtruesi i ankesës si prova ka bashkangjitur foton të postuar në facebook dhe videon në CD nga postimi në fjalë.

Më datë 01.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 02.02.2025.

Në Përgjigjen në ankesën Anr.281/2025, subjekti politik PLE ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të ankesës, pasi që në lidhje me videoinçizimin e dt.31.01.2025, të paraqitur në Tiktok nga Bashkim Krasniqi , me mbishkrimin “ Punët e mira i bëjmë vetëm ne”, apo videoinçizimin me titull “ Behet me shpi te re nena me 6 fëmijë jetim” video që pala ankuese pretendon nuk është aktuale dhe nuk ka te beje me kohen e fushatës zgjedhore dhe se kjo video është bere shume kohe me pare (23 Gusht 2023) , e cila nuk ka te beje aspak me fushatën dhe nuk përmban asnjë simbol te PLE-së, nuk përmban as numër te Partisë Liberale Egjiptiane me te cilën garon dhe nuk lidhet me asnjë aktivitet te fushatës zgjedhore, dhe është një video e publikuar shume muaj me herët. Me tutje ne përgjigje ne ankesë thekson se është fjala për një donacion për ndërtimin e shtëpisë te B.B, e cila është ndërtuar ne vitin 2023 ne verë, pra shume kohe para fushatës zgjedhore ku edhe shihen personat me veshje verore, e jo me veshje dimërore dhe është e palogjikshme te ngritët një pretendim i pabazuar se kjo video ka te beje me fushate siç shihet edhe nga gjendja faktike e paraqitur ne te, se asnjë simbol apo numër i partisë nuk është i paraqitur ne videon e publikuar, dhe se videoinçizimi dhe fotografit janë publikuar para me shume se 1 vit e gjysmë dhe se nga ajo kohe gjenden ne rrjetet sociale. Në përgjigje në ankesë theksohet se këto janë aktivitete të bamirësisë për familjen e te ndjerit B.B, ku shihet nëna se bashku me fëmijët e mitur që ka dhënë autorizim për paraqitjen e fëmijëve gjate pranimit te çelësave të shtëpisë dhe ne asnjë mënyrë nuk paraqitet si angazhim i fëmijëve ne fushat zgjedhore por ishte vetëm aktivitet për qëllime bamirësie. Andaj konsiderojmë se PLE nuk ka bere shkelje te nenit 5 par.3 te Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, monitorimin e fushatës të zgjedhjeve dhe deklarimi financiar, videot dhe fotot janë nga pranimi i shtëpisë të ndërtuar në muajin Gusht 2023 dhe në asnjë mënyrë nuk është angazhuar asnjë fëmijë apo person nën moshën 15vjec.Propozojn që PZAP-i, pas analizimit të gjendjes faktike dhe administrimit të provave të bashkangjitura, ta refuzoj ankesën, pasi që asnjë pretendim i paraqitur në ankesë nuk është vërtetuar.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti Partia Liberale Egjiptiane-PLE, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar neni 5paragrafi 3 parasheh se “*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk*

mund të angazhoje persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.”, me arsyetimin se bazuar në përgjigjen në ankesën Anr.281/2025 rezulton se në videon e publikuar nuk ka asnjë ndërlidhje me fushatën zgjedhore dhe se nuk përmban asnjë simbol të partisë PLE apo numër me të cilin garon subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane, fakt ky që e argumentojnë edhe provat e bashkangjitura si fotografit dhe videoincizimi, i cili është bërë në muajin Gusht 2023, ku shihet vetëm dorëzimi i çelësave të shtëpisë për bamirësi fëmijëve në prezencën e nënës së tyre, dhe në asnjë mënyrë nuk janë keqpërdorur prezencat e fëmijëve për fushatë zgjedhore.


Paneli ka zbatuar edhe hetim lidhur e këtë çështje dhe ka konstatuar se publikimi ka të bëjë me muajin gusht të vitit 2023, ashtu siç është cekur në ankesë. Ndërsa ka konstatuar se fotografia e paraqitur me ankesë nuk përmban datë dhe detaje të tjera, të cilat do ta identifikonin se e njëjta është publikuar apo ri postuar nga kandidati në fjalë në datën e cekur në ankesë.

Bazuar në nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, dhe me qenes në këtë rast nuk ka prova të tilla, paneli vlerësoj se pretendimet e tilla nuk kanë mbështetje, andaj ankesën si të tillë e refuzoj, meqë ka vërtetuar se në këtë rast nuk kemi shkelje të rregullave zgjedhore dhe shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nën nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.281/2025 datë 03.02.2025

Kryesuese i Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.